




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Radio Klan Kosova FM  
Arbër Geci  
Drejtor  
Prishtinë



VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2023/190 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për Radio Klan Kosova FM Prishtinë (Pala Përgjegjëse)

Faktet

1. Pala përgjegjëse me datën 30 tetor 2009 është pajisur me licencë të KPM-së me seli në Prishtinë. Me marrjen e Licencës Pala përgjegjëse është obliguar që të respektojë Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës si dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM.
2. KPM me datë 17 dhjetor 2021 ka nxjerrë Rregulloren KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale. Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret, të drejtat dhe obligimet për ofruesit e shërbimeve mediale, pa marrë parasysh mënyrën e transmetimit në Republikën e Kosovës, me qëllim të garantimit të mbrojtjes së pluralizmit medial dhe interesit publik, si dhe të mundësohet garë e drejtë dhe e barabartë në tregun medial në Republikën e Kosovës.
3. Me datë 30 tetor 2016 Komisioni i KPM-së mori Vendim për ripërtëritjen e licencës së Palës përgjegjëse edhe për një afat prej shtatë (7) viteve për të ushtruar veprimtari në ofrimin e shërbimeve mediale audio, ashtu siç përcaktohet me nenin 21, paragrafi 2, të Ligjit për KPM-në.
4. Me vendimin e Komisionit të KPM-së të datës 15 dhjetor 2020, është ndryshuar pronësia e Palës përgjegjëse, respektivisht pronarit si person fizik dhe është transferuar licenca nga z. Aleksandër Frangaj tek personi juridik KGO Media Investments DOOEL, me shifrën EMBS 7115326, me pronar z. Kushtrim Gojani, në kudër të biznesit Klan Kosova Sh.p.k. me numër unik identifikues 810795297, në pronësi të së cilit biznes është edhe Pala përgjegjëse.
5. KPM, me Vendimin e datës 16 nëntor 2021 ka bërë ndryshimin e pronësisë së Radio Kent FM Prishtinë (dhe ndryshimin e emrit në Radio Klan Kosova FM Prishtinë) dhe kalimin e saj nga biznesi Engin Beyoglu B.I. me emrin tregtar Radio Kent FM dhe me numër unik identifikues 810479475, tek biznesi Klan Kosova Sh.P.K. me numër unik identifikues 810795297 dhe me pronar personin juridik KGO Media Investments Holding me numër unik identifikues 811575804 me seli në Prishtinë, ndërsa ky biznes me pronar personin juridik KGO Media

Investments DOOEL, me shifrën EMBS 7115326 me seli në Shkup - Maqedonia e Veriut me z. Kushtrim Gojani si pronar.

6. KPM, gjatë vlerësimit të kërkesës për ripërtëritje të licencës së Palës përgjegjëse e cila radio është pjesë e Klan Kosova Sh.P.K. me numër unik identifikues 810795297, ka vërejtur se në certifikatën e licencës së këtij biznesi në vend të pronarit personi juridik KGO Media Investments DOOEL, me shifrën EMBS 7115326 me seli në Shkup - Maqedonia e Veriut me z. Kushtrim Gojani, si pronar tani figuron emri i biznesit KGO Media Investments Holding me numër unik identifikues 811575804 si pronar, me seli në Prishtinë, duke bërë kështu ndryshime në pronësi të Palës përgjegjëse pa miratim paraprak të KPM-së.
7. KPM, bazuar në Raportin e Departamentit të Licencimit të datës 21 dhjetor 2023 ka gjetur se Pala përgjegjëse ka bërë ndryshim të pronësisë në certifikatën e regjistrimit të biznesit pa miratim paraprak të KPM-së, respektivisht duke ndryshuar biznesin si pronar duke vepruar kështu në kundërshtim me Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës dhe Rregulloren KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

#### Analiza ligjore

8. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse është gjetur në shkelje të Ligjit të KPM-së, Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, dhe Rregullore KPM-2021/01 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.
9. Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 21, paragrafi 3, i Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se:

*“Licencat nuk mund të shfrytëzohen dhe barten pa autorizimin dhe pa aprovimin paraprak me shkrim të KPM-së.”*

10. Në kundërshtim me nenin 18, të Rregullore KPM-2021/01, i cili përcakton se:

*“Licencat nuk mund të shfrytëzohen dhe transferohen pa autorizim dhe pa aprovim paraprak me shkrim nga KPM.”*

11. Në kundërshtim me nenin 15, paragrafi 2, paragrafi 2.1, paragrafi 2.2 dhe paragrafi 3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, të cilët përcaktojnë se:

*2. “I licencuari nuk mund të bartë licencën ose frekuenc-ën(at) pa miratimin paraprak me shkrim të KPM-së.”*

*2.1. “Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose*

*ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së.”*

*2.2. "Kjo kërkesë do të zbatohet gjithashtu në rastin e ndryshimit të udhëheqësisë së të licencuarit, që është regjistruar si OJQ, në përputhje me Rregulloren e KPM-së për Kriteret Kualifikuese për Marrjen e Licencës. Në rastin kur KPM lejon transferimin e Licencës, në asnjë rrethanë nuk do të paguhet e as të pranohet asnjë kompensim financiar për transferimin e kësaj licence.”*

*3. "Kontrolli Efektiv i Frekuencës: I Licencuari nuk do të transferojë kontrollin efektiv të një frekuence të licencuar tek një palë e tretë, plotësisht ose pjesërisht, pa autorizim paraprak me shkrim nga ana e KPM-së.”*

12. KPM bazuar në Raportin e Departamentit të Licencimit ka gjetur se Pala përgjegjëse ka bërë ndryshim të pronësisë në certifikatën e regjistrimit të biznesit pa miratim paraprak të KPM-së, respektivisht duke ndryshuar biznesin si pronar.
13. KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 21, paragrafin 3, të Ligjit të KPM-së, nenit 18, të Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2021/01, dhe nenit 15, paragrafi 2, paragrafi 2.1, paragrafi 2.2, dhe paragrafi 3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

### Vendim


14. Pala përgjegjëse, sanksionohet me **Gjobë** në shumë prej njëmijë (1.000) euro në pajtim me nenin 30 paragrafi 1.3 të Ligjit të KPM-së, për shkeljet të vazhdueshme të nenit 21, paragrafin 3, të Ligjit të KPM-së, nenin 18 Rregullores për Ofruesit e shërbimeve Mediale Audio dhe Aidiovizuale-KPM-2021/01, nenit 5, paragrafin 5.2, dhe paragrafin 5.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
15. Pala përgjegjëse, obligohet që në afat prej tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij Vendimi ta dorëzoj kërkesën së bashku me dokumentet e nevojshme për ndryshim të pronësisë, ashtu siç është e përcaktuar me nenin 21, paragrafi 3, të Ligjit të KPM-së, nenin 18, të Rregullores për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Aidiovizuale KPM-2021/01, dhe nenit 15, paragrafi 2, paragrafi 2.1, paragrafi 2.2, dhe paragrafi 3, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
16. Pala Përgjegjëse obligohet që gjobën në shumë prej njëmijë (1.000) euro e përcaktuar nga pika 14 e këtij vendimi, ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në xhirollogarinë e KPM-së numër: 1000400070001635.

17. Në rast se Pala Përgjegjëse nuk e paguan gjobën brenda afatit të përcaktuar në pikën 15 të këtij vendimi, i njëjti kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme në procedurë përmbarimore.

### E drejta për ankesë

18. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.

19. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Jeton MEHMETI  
Kryetar



15.04.2024

Datë